



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 125/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 18.03.2021, shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e shoqërisë “Intermed” sh.p.k në procedurën e prokurimit me Nr.REF-82091-12-14-2020, me objekt: *“Blerje bari “Favipiravir 200 mg, Njësia Tabletë” për nevoja te QSU “Nënë Tereza” për një periudhë 12 mujore*”, me fond limit 76,969,446.20 lekë pa TVSH, zhvilluar me date 11.01.2021, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

Ankimues: “Intermed” sh.p.k
Rruga ‘Ismail Qemali’, 12/1, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.
Rruga e Dibrës Nr. 372, Tiranë

Subjekte të Interesuar: “Pegasus” sh.p.k
Rruga Siri Kodra, tek ish frigoriferi, Nr. 149, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr.

596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, Vendim i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 15.12.2020 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit me Nr.REF-82091-12-14-2020, me objekt: “Blerje bari ‘Favipiravir 200 mg, Njësia Tabletë’ për nevoja te QSU “Nënë Tereza” për një periudhë 12 mujore”, me fond limit 76,969,446.20 lekë pa TVSH, zhvilluar me date 11.01.2021, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

II.2. Në datën 29.01.2021 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht për klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar. Nga vlerësimi i bërë nga KVO-ja rezulton si më poshtë:

1.	“Intermed” sh.p.k	11.663.200 lekë, skualifikuar
2.	“Pegasus” sh.p.k	18.910.000 lekë, kualifikuar
3.	“Incomed” sh.p.k	19.276.000 lekë, skualifikuar
4.	“Farma Net Albania” sh.p.k	23.790.000 lekë, kualifikuar
5.	“Evita” sh.p.k	36.600.000 lekë, kualifikuar
6.	“Eurofarma TQ Tolica” sh.p.k	44.408.000 lekë, skualifikuar
7.	“Fufarma” sh.p.k	45.018.000 lekë, kualifikuar
8.	“Megafarma” sh.p.k	45.237.600 lekë, kualifikuar

Operatori ekonomik “Intermed” sh.p.k rezulton i skualifikuar me argumentet e mëposhtme:

Në DST kërkohet që: ç) Kërkohet Autorizim: – Në rastin e parashikuar në pikën “b” të kriterëve të kapacitetit teknik të DST, kërkohet Autorizim nga MAH (Mbajtësi i Autorizimit të Tregtimit) ose distributori i autorizuar (ku të provohet/dokumentohet lidhja e këtij të fundit me MAH) nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë barnat e tyre. Autorizimi duhet të jetë i vlefshëm për të gjithë periudhën e kërkuar. – Në rastin e parashikuar në pikën “c” të kriterëve të kapacitetit teknik të DST, kërkohet Autorizim nga MAH (Mbajtësi i Autorizimit të Tregtimit) ose nga prodhuesi ose distributori i autorizuar (ku të provohet/dokumentohet lidhja mes këtij të fundit dhe MAH apo prodhuesit) nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë barnat e tyre. Autorizimi duhet të jetë i vlefshëm për të gjithë periudhën e kërkuar.

OE, është i autorizuar nga CorenaTherapeuticsv Sarl. Nuk provohet/dokumentohet lidhja me MAH/Prodhuesin. OE ka paraqitur vërtetim nga Neutec i cili autorizon CorenaTherapeutics Sarl për të blerë produktin nga prodhues të autorizuar apo distributor të licensuar dhe jo nga vetë Neutec i cili është prodhues dhe mbajtës i MAH. Gjithashtu nuk citohet se nga do të blihet produkti, duke mos garantuar në këtë mënyrë përmbushjen e kontratës si dhe përmbushjen e germës ç të DST. Corena TH Sarl, nuk është distribuor i Neutec dhe as MAH. OE nuk përmbushur kriteret e përcaktuara nga AK në DST, sipas përcaktimeve të nenit 53, pika 3, 4, 5/c, dhe nenit 54 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, si dhe Kreut VII, neni 66, pika 3, të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

II.3. Në datën 02.02.2021, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, nëpërmjet të cilës kundërshton skualifikimin e tij në procedurën e prokurimit. Konkretisht pretendohet si vijon:

“Arsyet e refuzimit të ofertës sonë janë si më poshtë:

Në DST kërkohet që: ç) Kërkohet Autorizim: – Në rastin e parashikuar në pikën “b” të kriterëve të kapacitetit teknik të DST, kërkohet Autorizim nga MAH (Mbajtësi i Autorizimit të Tregtimit)

ose distributori i autorizuar (ku të provohet/dokumentohet lidhja e këtij të fundit me MAH) nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë barnat e tyre. Autorizimi duhet të jetë i vlefshëm për të gjithë periudhën e kërkuar.

– Në rastin e parashikuar në pikën “c” të kriterëve të kapacitetit teknik të DST, kërkohet Autorizim nga MAH (Mbajtësi i Autorizimit të Tregtimit) ose nga prodhuesi ose distributori i autorizuar (ku të provohet/dokumentohet lidhja mes këtij të fundit dhe MAH apo prodhuesit) nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë barnat e tyre. Autorizimi duhet të jetë i vlefshëm për të gjithë periudhën e kërkuar.

OE, është i autorizuar nga CorenaTherapeuticsv Sarl. Nuk provohet/dokumentohet lidhja me MAH/Prodhuesin. OE ka paraqitur vërtetim nga Neutec i cili autorizon CorenaTherapeutics Sarl për të blerë produktin nga prodhues të autorizuar apo distributor të licensuar dhe jo nga vetë Neutec i cili është prodhues dhe mbajtës i MAH. Gjithashtu nuk citohet se nga do të blihet produkti. Duke mos garantuar në këtë mënyrë përmbushjen e kontratës si dhe përmbushjen e germës ç të DST. Corena TH Sarl, nuk është distributor i Neutec dhe as MAH. OE nuk ka përmbushur kriteret e përcaktuara nga AK në DST, sipas përcaktimeve të nenit 53, pika 3, 4, 5/c, dhe nenit 54 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, si dhe Kreut VII, neni 66, pika 3, të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Së pari, në lidhje me produktin Favipiravir, bëhet fjalë për një bar të paregjistruar në Republikën e Shqipërisë dhe si i tillë, sipas pikës ç), ne kemi paraqitur në përmbushje të DST, Autorizim nga distributori i autorizuar Corena Therapeutics Srl.

Në rastin kur autorizimi paraqitet nga distributori i autorizuar, sipas DST kërkohet të provohet/dokumentohet lidhja mes këtij të fundit dhe MAH apo prodhuesit. Pra kërkohet të dokumentohet lidhja mes Corena Therapeutics SRL (distributor i autorizuar) dhe Neurec (prodhues i produktit final dhe MAH i certifikatës së regjistrimit në Turqi).

Kjo pikë është përmbushur plotësisht mbështetur në Autorizimin që Neutec Ilac Sanayi Ticaret lëshon kundrejt kujt t'i interesojë dhe specifikisht në paragrafin e parë autorizon Corena Therapeutics të exportojë sasinë 6400 kuti Favimol 200 mg në Shqipëri. Gjithashtu në paragrafin e fundit është shumë e qartë që prodhues gjithashtu dhe MAH në Turqi është Neutec.

Pretendimi që ju keni ngritur që nuk provohet/dokumentohet lidhja midis MAH/Prodhuesin, nuk qëndron. Interpretimi që ju i keni bërë autorizimit është subjektiv, duke shkëputur nga konteksti një fjali dhe duke e keqinterpretuar. Nuk mund të shkëputet konteksti nga përmbajtja nga një dokument i lëshuar në këtë format pikërisht nga Neutec si MAH dhe Prodhuesi i produktit final, si dhe në ligjëratë të drejtë juridike të mos respektohen shenjat e pikësimit dhe deklaratimet eksplicite në këtë autorizim. Nëse KVO është e paqartë ose ka dyshime rezervon të drejtën e verifikimit të të dhënave të paraqitura nga ofertuesi por jo të arrijë në konkluzione nisur nga interpretime subjektive.

Pika tjetër që ne kundërshtojmë është që nuk citohet se nga do të blihet produkti. Në asnjë fjali në DST nuk kërkohet të citohet se nga do të blihet produkti. Pra ju nuk e kërkonit që të citohet dhe të dokumentohet me ndonjë dokument specifikisht.

Por gjithsesi nga dokumentat e dorëzuar nga ana jonë si nga Autorizimi i MAH-së Neutec për distributorin e autorizuar Corona si nga Autorizimi i Corena Therapeutics Sarl për Intermed, është e qartë që ne produktin do ta blejmë ndërmjet këtij të fundit.

Gjithashtu Intermed ka paraqitur në përmbushje të kriterëve të vecanta të DST, Deklaratë mbi origjinën e mallit (vendi i prodhimit dhe kompaninë prodhuese/MAH) për barin e ofertuar.

Nga sa argumentuam pretendimi juaj që Intermed nuk garanton në këtë mënyrë përmbushjen e kontratës si edhe përmbushjen e gjermës ç të DST bie poshtë.

Së treti ju keni arritur konkluzionin që Corena Therapeutics nuk është distributor zyrtar i autorizuar. Kjo gjë është shprehur në mënyrë eksplicite në Autorizimin e Neutec për Corena Therapeutics Sarl, si dhe në Pragraftin e parë të autorizimit të Corena Therapeutics Sarl për Intermed shprehimisht thuhet: “Ne të nënshkruarit dhe zyrtarisht të autorizuar për export ndërkombëtar nga MAH Neutec ILAC Sanayi autorizojmë kompaninë Intermed...”

Gjithashtu Neutec përmes autorizimit të tij, autorizon për eksport në Shqipëri Corena Therapeutics. Sikurse qartësisht vihet re Corena Therapeutics Sarl është distributor i Neutec.

Nuk kërkohet në DST ndonjë dokument shtesë që vërteton që Corena është distributor i Autorizuar i Neutec. Fakti që Neutec lëshon një autorizim për Corenën është mëse i mjaftueshëm për të vërtetuar lidhjen mes tyre.

Nga sa argumentuam kërkojmë që ankesa jonë të merret parasysht dhe AK të anulohet vendimin e refuzimit në mënyrë të padrejtë dhe të pabazuar të ofertës sonë.”

II.4. Nëpërmjet shkresës nr. 494/4 prot., datë 11.02.2021 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimesit si vijon:

“ [...]

KSHA mori në shqyrtim pretendimet e OE ankues, ku në vijim konstatoi se: [...]

Në DST përcaktohet në pikën 2.3 Kapaciteti teknik:

b) *Për barnat e autorizuar për tregtim në Republikën e Shqipërisë, duhet të paraqitet dokument, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (AKBPM) që bari i ofertuar është i pajisur me autorizim për tregtim në Republikën e Shqipërisë ose certifikatë regjistrimi e barit për tregtim në RSH, brenda afatit të vlefshmërisë.*

c) *Për barnat e paautorizuara për tregtim në Republikën e Shqipërisë, bari që ofertohet duhet:*

- të ketë marrë autorizim për tregtim dhe të qarkullojë në njërin nga vendet e Bashkimit Evropian, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kanada, Turqi, Zvicër, Izrael, Japoni, Australi; ose/

- të jetë i prodhuar në vendet e Ballkanit, vetëm kur ka marrë autorizim për tregtim dhe qarkullon në vendin e tyre,

ose/

- të jetë i pajisur me autorizimin e tregtimit nga Agjencia Evropiane e Vlerësimit të Barnave (EMA) ose Institucioni i Administrimit për Ushqimin dhe Barnat (FDA) i Shteteve të Bashkuara të Amerikës,

Për këtë kërkohet që ofertuesi të paraqesë:

Deklaratë me anën e të cilës të konfirmohet se bari që ofron është i pajisur me autorizim tregtimi dhe qarkullon në një nga vendet e mësipërme ose që disponon autorizim tregtimi nga FDA ose EMA.

Në deklaratën e nënshkruar dhe të vulosur nga ofertuesi duhet të deklarohen: Emri dhe adresa e plotë e Institucionit/eve të autorizuar që kanë lëshuar autorizimin e tregtimit; Të dhëna kontakti për këto institucione (Tel, fax, e-mail, web-site); Data e lëshimit të autorizimit të tregtimit të barit që ofron, (pranë këtij institucioni) dhe periudhën e vlefshmërisë të këtij autorizimi.

ç) Kërkohe Autorizim:

- Në rastin e parashikuar në pikën "b" të kriterëve të kapacitetit teknik të DST, kërkohet autorizim nga MAH (Mbajtësi i Autorizimit të Tregtimit) ose distributori i autorizuar (ku të provohet/dokumentohet lidhja e këtij të fundit me MAH) nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë barnat e tyre. Autorizimi duhet të jetë i vlefshëm për të gjithë periudhën e kërkuar.

- Në rastin e parashikuar në pikën "c" të kriterëve të kapacitetit teknik të DST, kërkohet Autorizim nga MAH (Mbajtësi i Autorizimit të Tregtimit) ose nga prodhuesi ose distributori i autorizuar (ku të provohet/dokumentohet lidhja mes këtij të fundit dhe MAH apo prodhuesit) nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë barnat e tyre. Autorizimi duhet të jetë i vlefshëm për të gjithë periudhën e kërkuar.

d) Deklaratë e ofertuesit mbi origjinën e mallit (vendi i prodhimit dhe kompaninë prodhuese i MAH) për barin e ofertuar.

Referuar Regjistrin të Barnave të publikuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (<http://akbpm.gov.al>) rezulton se nuk ka bar të regjistruar me princip aktiv Favipinavir 200 mg (tabletë), pra rrjedhimisht OE-të pjesëmarrëse kanë ofertuar me bar të paregjistruar në RSH.

Për përmbushjen e kriterit të sipërcituar në gjurmën C, dhe gjurmën Ç paragrafi i dytë rezulton se OE ka administruar në SPE dokumentacion:

I. Me përshkrim Autorizim_MAH_-Intermed ka paraqitur: Letër Autorizimi nga Corena Therapeutics Sarl, e datës 28.12.2020, me Vërtetim Njësie me Origjinalin me nr. REP 7749, datë 30.12.2020 Noter Xh. Brahaj dhe Vërtetim Përkthimi nr. REP 7751, datë 30.12.2020 Noter Xh. Brahaj, ku OE Intermed autorizohet që:

1. Të veprojë si shoqëri e vetme blerjeje, importi dhe shpërndarje i produktit tonë të regjistruar, për të vepruar ligjrisht dhe formalisht me Subjektet Publike dhe Private Shqiptare (Ministria e Shëndetësisë, Agjencia Kombëtare e Barnave, Agjencia e Prokurimeve Publike

dhe autoritete të tjera shëndetësore në emër të Corena Therapeutics Sarl, përkatësisht nga MAH) gjatë dhe pas procedurës së prokurimit dhe regjistrimit në Shqipëri.

2. Të nënshkruajë çdo lloj forme aplikimi për procedurat e importit dhe shpërndarjes dhe përgatisë dokumentacionin e nevojshëm ose përkthimet dhe të ekzekutojë të gjitha aktet e tjera që mund të kërkohen për importimin dhe shpërndarjen e produkteve tona në Republikën e Shqipërisë.

II. Me përshkrim Autorizim_Prodhuesi_-MAH me Vërtetim Njësie me Origjinalin me nr. REP 7748, datë 30.12.2020 Noter Xh. Brahaj dhe Vërtetim Përkthimi nr. REP 7750, datë 30.12.2020 Noter Xh. Brahaj ka paraqitur letër nga me logo të Neutec Ilac .. [..], datë 30.12.2020, me firmë dhe vulë por pa të dhëna të titullarit i cili përfaqëson shoqërinë Neutec, ku citohet: Neutec Ilaç San. Tic. AS mund të lëshojë këtë dokument për të autorizuar eksportimin e 6400 pako Favimol 200 mg, 40 tableta për në Shqipëri, nëpërmjet Corena Therapeutics Sarl. Corena Therapeutics Sarl blen produkte direkt nga prodhuesit e licensuar ose distributorët e autorizuar të licensuar të prodhuesit.

Me anë të së cilës korfirmohet se produkti Favimol 200 mg, 40 tab, është prodhuar nga Neutec Ilaç Tic. A.S. dhe tregtohet dhe regjistrohet në Turqi.

III. Deklaratë Origjine ku deklarohej se prodhuesi i produktit është shoqëria Neutec Ilaç San.Tic.A.S., dhe vendi i prodhimit është: ARIFIYE/SAKARYA Turqi;

IV. Vërtetim _regjistrim_bari_Turqi, me Vërtetim Njësie me Origjinalin me nr. REP 7752, datë 31.12.2020 Noter Xh. Brahaj dhe Vërtetim Përkthimi nr. REP 7753, date 31.12.2020, Noter Xh. Brahaj, ku evidentohet fakti se bari është i regjistruar në Turqi, dhe mbajtësi i Autorizimit/Prodhuesit është shoqëria Neutec Ilac.

Referuar dispozitave ligjore në fuqi të parashikuara në Legjislacionin e Prokurimit Publik dhe Rregullat e Prokurimit Publik, KSHA del në konkluzionin ligjor se është vetë AK që përcakton mallrat me të cilët synon të furnizohet nëpërmjet prokurimit, specifikimet teknike që duhet të përmbushin këto mallra, si dhe harton kriteret e nevojshme që një ofertues i mundshëm duhet të plotësojë që të kualifikohet si ofertues në procedurën e prokurimit të cilën vetë AK e shpall sipas procedurave ligjore në fuqi, nëpërmjet Dokumenteve Standarde të Tenderit të hartuara dhe miratuara nga APP sipas parashikimit ligjor. AK në DST, për barnat e paautorizuara kërkon strictu sensu që çdo Operator Ekonomik ofertues të plotësojë në mënyrë rigoroze nëpërmjet dokumentacionit teknik e ligjor i cili ngarkohet në formë elektronike sipas përcaktimeve ligjore që të vërtetohet lidhja e operatorit ekonomik me MAH ose Distributorin Zyrtar të Autorizuar të Prodhuesit ose Prodhuesin, në mënyrë që të provohet/dokumentohet lidhja mes këtij të fundit (OE Ofertues) dhe MAH apo prodhuesit të barit objekt prokurimi. Në dokumentacionin e paraqitur (Autorizim nga Corena) kjo e fundit e autorizon ankuesin për të vepruar si shoqëri e vetme blerjeje, importi dhe shpërndarje i produktit tonë të regjistruar, ndërkohë që sipas dokumentacionit të administruar në SPE, produkti i ofertuar nuk është produkti i prodhur nga Corena Therapeutics Sarl, apo produkti i regjistruar në Zvicër, si dhe CorenaTH Sarl në asnjë moment nuk evidentohet të jetë distributor zyrtar i Neutec Ilac, apo të jetë mbajtës i MAH për barin e ofertuar. Gjithashtu

në dokumentin e ngarkuar me përshkrim Autorizim_Prodhuesi_-MAH me Vërtetim Njësie me Originalin me nr. REP 7748, datë 30.12.2020 Noter Xh. Brahaj dhe Vërtetim Përkthimi nr. REP 7750, datë 30.12.2020 Noter Xh. Brahaj ka paraqitur leter nga me logo të Neutec Ilac .. [..], datë 30.12.2020, citohet se: Neutec Ilac San. Tic. AS mund të lëshojë këtë dokument për të autorizuar eksportimin e 6400 pako Favimol 200 mg, 40 tableta për në Shqipëri, nëpërmjet Corena Therapeutics Sarl. Corena Therapeutics Sarl blen produkte direkt nga prodhuesit e licensuar ose distributoret e autorizuar të licensuar të prodhuesit. Në asnjë moment në dokumentacionin e administruar me logo dhe vulë të Neutec nuk citohet fakti se CorenaTH Sarl është distributor zyrtar i prodhuesit, por citohet se kjo e fundit do ta blejë produktin nga prodhuesit e licensuar ose distributorit të autorizuar të licensuar të prodhuesit duke mos evidentuar se ku do ta blej produktin CorenaTH Sarl.

Në DST kërkohet strictu sensu që OE ofertues të paraqesë Autorizim nga MAH (Mbajtësi i Autorizimit të Tregtimit) ose nga prodhuesi ose distributori i autorizuar (ku të provohet/dokumentohet lidhja mes këtij të fundit dhe MAH apo prodhuesit) dhe në dokumentacionin e dorëzuar në SPE nuk evidentohet në asnjë moment dorëzimi i Autorizimit nga MAH/Prodhuesi/Distributori i Autorizuar i Prodhuesit.

Sqarojmë se në një procedurë prokurimi, operatori ekonomik i interesuar ka detyrimin ligjor për të plotësuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar në DST nga AK, sipas kuptimit klasik të barrës së provës kur barra e provës i bie kërkuarit, në këtë rast ofertuesit i cili ka detyrimin ligjor të që plotësojë kërkesat e DST nëpërmjet dokumentacionit teknik, në këtë rast autorizimi i prodhuesit i cili duhet të jetë detyrimisht i lëshuar nga MAH, Prodhuesi, ose Distributori i Autorizuar i Prodhuesit. Kjo referuar dhe përcaktimeve ligjore të parashikuara në nenin 46/1 të LPP ku citohet se: Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurrohet dhe jodiskriminuese, gërma b) ku citohet se: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;

Dhe në këtë kuadër, KSHA vlerëson se KVO ka vlerësuar drejtë dhe në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për sa i përket skualifikimit të OE Intermed Shpk., dhe për pasojë pretendimi i ngritur nga OE Intermed Shpk., nuk qëndron.

II.5. Në datën 16.02.2021 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt si edhe në autoritetin kontraktor.

II.6. Në datën 02.03.2021 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 258/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 494/8 prot., datë 24.02.2021, bashkëngjitur informacioni e dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues se: “Në DST kërkohet që: ç) Kërkohet Autorizim: – Në rastin e parashikuar në pikën “b” të kriterëve të kapacitetit teknik të DST, kërkohet Autorizim nga MAH (Mbajtësi i Autorizimit të Tregtimit) ose distributori i autorizuar (ku të provohet/dokumentohet lidhja e këtij të fundit me MAH) nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë barnat e tyre. Autorizimi duhet të jetë i vlefshëm për të gjithë periudhën e kërkuar. – Në rastin e parashikuar në pikën “c” të kriterëve të kapacitetit teknik të DST, kërkohet Autorizim nga MAH (Mbajtësi i Autorizimit të Tregtimit) ose nga prodhuesi ose distributori i autorizuar (ku të provohet/dokumentohet lidhja mes këtij të fundit dhe MAH apo prodhuesit) nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë barnat e tyre. Autorizimi duhet të jetë i vlefshëm për të gjithë periudhën e kërkuar.

OE, është i autorizuar nga CorenaTherapeuticsv Sarl. Nuk provohet/dokumentohet lidhja me MAH/Prodhuesin. OE ka paraqitur vërtetim nga Neutec i cili autorizon CorenaTherapeutics Sarl për të blerë produktin nga prodhues të autorizuar apo distributor të licensuar dhe jo nga vetë Neutec i cili është prodhues dhe mbajtës i MAH. Gjithashtu nuk citohet se nga do të blihet produkti. Duke mos garantuar në këtë mënyrë përmbushjen e kontratës si dhe përmbushjen e germës ç të DST. Corena TH Sarl, nuk është distributor i Neutec dhe as MAH. OE nuk ka përmbushur kriteret e përcaktuara nga AK në DST, sipas përcaktimeve të nenit 53, pika 3, 4, 5/c, dhe nenit 54 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, si dhe Kreut VII, neni 66, pika 3, të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 9 “Kriteret e Veçanta për Kualifikim”, “Kapaciteti teknik”, gërmat “b”, “c”, “ç”, “d” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi, është përcaktuar kriteri si më poshtë:

b)Për barnat e autorizuara për tregtim në Republikën e Shqipërisë, duhet të paraqitet dokument lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve autorizim për tregtim në Republikën e Shqipërisë ose certifikatë regjistrimi e barit për tregtim në RSH, Mjekësore(AKBPM), që bari i ofertuar është i pajisur me brenda afatit të vlefshmërisë.

c) Për barnat e paautorizuara për tregtim në Republikën e Shqipërisë, bari që ofertohet duhet:
 - të ketë marrë autorizim për tregtim dhe të qarkullojë në njërin nga vendet e Bashkimit European, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kanada, Turqi, Zvicër, Izrael, Japoni, Australi; /ose/
 - të jetë i prodhuar në vendet e Ballkanit, vetëm kur ka marrë autorizim për tregtim dhe qarkullon në vendin e tyre,

/ose/

- të jetë i pajisur me autorizimin e tregtimit nga Agjencia Europiane e Vlerësimit të Barnave (EMA) ose Institucioni i Administrimit për Ushqimin dhe Barnat (FDA) i Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Për këtë kërkohet që ofertuesi të paraqesë:

- Deklaratë me anën e së cilës të konfirmohet se bari që ofron është i pajisur me autorizim tregtimi dhe qarkullon në një nga vendet e mësipërme ose që disponon autorizim tregtimi nga **FDA ose EMA.**

Në deklaratën e nëshkruar dhe të vulosur nga ofertuesi duhet të deklarohen: Emri dhe adresa e plotë e Institucionit/eve të autorizuar që kanë leshuar autorizimin e tregtimit; Të dhëna kontakti për këto institucione (Tel, fax, e-mail, web-site); Data e lëshimit të autorizimit të tregtimit të barit që ofron, (pranë këtij institucioni) dhe periudhën e vlefshmërisë të këtij autorizimi.

ç) Kerkohet Autorizim:

- Në rastin e parashikuar në pikën “b” të kritereve të kapacitetit teknik të DST, kërkohet Autorizim nga MAH (Mbajtësi i Autorizimit të Tregtimit) ose distributori i autorizuar (ku të provohet/dokumentohet lidhja e këtij të fundit me MAH) nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë barnat e tyre. Autorizimi duhet të jete i vlefshem per te gjithë periudhen e kerkuar.
- Në rastin e parashikuar në pikën “c” të kritereve të kapacitetit teknik të DST, kërkohet Autorizim nga MAH (Mbajtësi i Autorizimit të Tregtimit) ose nga prodhuesi ose distributori i autorizuar (ku të provohet/dokumentohet lidhja mes këtij të fundit dhe MAH apo prodhuesit) nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë barnat e tyre. Autorizimi duhet të jetë i vlefshëm për të gjithë periudhën e kërkuar.

d) Deklaratë e ofertuesit mbi origjinen e mallit (vendi i prodhimit dhe kompaninë prodhuese / MAH) për barin e ofertuar.

III.1.2. Në shtojcën 10 “Specifikimet teknike” të dokumenteve të procedurës së mësipërme të prokurimit është parashikuar:

<i>Principi aktiv</i>	<i>Formë/doza</i>	<i>Njësia</i>
Favipiravir	200 mg	Tabletë

- **Afati i skadencës: Data e skadencës në ditën e lëvrimit të mallit duhet të jetë jo më e vogël se ½ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës.**
- **Formë – doza dhe volumi për barin është përcaktuar dhe është detyruese.**

- **Konfeksionimi:** Mbi çdo konfeksion duhet të jetë shënuar emri i barit, formë-doza, kodi i barit, përqindja dhe përmbajtja, data e prodhimit dhe e skadimit, nr. i serisë, dhe shënimi <<PËRDORIM SPITALOR-NDALOHET SHITJA>>. Të gjitha barnat duhet të jenë të pajisura me pullën e kontrollit të barnave të lëshuar nga AKBPM.
- **Afati i lëvrimit për 12 muaj.**
 - 15% e sasisë së barit duhet të lëvrohet brenda 15 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.
 - pjesa e sasisë së mbetur duhet të lëvrohet deri në përfundim të kontratës dhe sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

Në shtojcën 12 “Sasia dhe grafiku i lëvrimit” është parashikuar:

Sasia e mallit që kërkohet:

Blerje bari: “Favipiravir 200 mg, Njësia Tablete” për nevoja të QSU “Nënë Tereza” për një periudhë 12 mujore :

Principi aktiv	Formë/doza	Njësia	Sasia
Favipiravir	200 mg	Tablete	244 000

Kontratat do të jepen brenda periudhës: nga momenti i lidhjes së Marrëveshjes Kuadër me OE shpallur fitues, **me afat përfundimtar 12 muaj nga data e nënshkrimit të MK.**

Afatet e lëvrimit: QSUT do të lidhë kontratë në bazë të nevojave të saj në çdo 4 mujor.

Përbashkëtimisht këtij përcaktimi, autoriteti kontraktor mund të lidhin kontratë për çdo nevojë që del e parashikuar dhe është e domosdoshme në çdo kohë.

Për çdo kontratë të lidhur brenda Marrëveshjes Kuadër, sipas përcaktimit më sipër, afatet e lëvrimit do të jenë si më poshtë:

- 15% e sasisë së secilit bar, duhet të lëvrohet maksimumi brenda 15 ditëve nga data nënshkrimit të kontratës dhe pjesa e sasisë së mbetur duhet të lëvrohet deri në përfundim të kontratës dhe sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

III.1.3. Nga shqyrtimi i ofertës së operatorit ekonomik ankimues “Intermed” sh.p.k rezulton se për plotësimin e kërkesës së autoritetit kontraktor, në SPE është paraqitur dokumentacioni i mëposhtëm:

1. Deklaratë për origjinën e mallrave ku operatori ekonomik “Intermed” sh.p.k deklaron se prodhues i produktit është kompania prodhuese Neutec Ilac San.Tic.A.S., dhe vendi i origjinës është: ARIFIYE/SAKARYA Turqi;
2. Dokumenti “Autorizim_MAH_Intermed”, i cili përmban Autorizim, lëshuar në datën 28.12.2020 nga kompania Corena Therapeutics Sarl, me përmbajtjen si vijon:
 “Ne, të nënshkruarit dhe të autorizuar rregullisht për eksportim ndërkombëtar Corena Therapeutics Sarl me adresë ..., nga mbajtësi i Autorizimit të Marketingut Neutec Ilac Sanayi Ticaret AS Esenler, Istanbul, Turkey, i produktit tonë të regjistruar me Autorizimin e Marketingut të dhënë në Turqi
 Emri i markës: FAVIMOL

INN: Favipiravil

Doza: 200 mg

Forma: Tabletë e veshur me film

Autorizon shoqërinë “Intermed” sh.p.k e regjistruar në adresën ... , e përfaqësuar nga znj. A.Maho ...dhe z.P.M ..., përfshirë në procedurat e mëposhtme:

- Të veprojë si shoqëri e vetme blerjeje, importi dhe shpërndarjeje i produktit tonë të regjistruar, për të vepruar ligjërisht dhe formalisht me Subjektet Publike dhe Private Shqiptare (Ministria e Shëndetësisë, Agjencia Kombëtare e Barnave, Agjencia e Prokurimeve Publike dhe autoritete të tjera shëndetësore në emër të Corena Therapeutics Sarl, përkatësisht nga MAH) gjatë dhe pas procedurës së prokurimit dhe regjistrimit në Shqipëri.
 - Të nënshkruajë çdolloj forme aplikimi për procedurat e importit dhe shpërndarjes dhe përgatisë dokumentacionin e nevojshëm ose përkthimet dhe të ekzekutojë të gjitha aktet e tjera, që mund të kërkohen për importimin dhe shpërndarjen e produkteve tona në Republikën e Shqipërisë. [...]”.
3. Dokumenti “Autorizim_Prodhuesi_-MAH” rezulton shkresë me logo të Neutec Ilaç Sanayi Ticaret AS, datë 30.12.2020, (me firmë dhe vulë), ku thuhet shprehimisht:
“Neutec Ilaç San. Tic. AS mund të lëshojë këtë dokument për të autorizuar eksportimin e 6400 pako Favimol 200 mg, 40 tableta për në Shqipëri, nëpërmjet Corena Therapeutics Sarl. Corena Therapeutics Sarl blen produkte direkt nga prodhuesit e licensuar ose distributorët e autorizuar të licensuar të prodhuesit.
Me anë të së cilës konfirmon se produkti Favimol 200 mg, 40 tab, është prodhuar nga Neutec Ilaç Tic. A.S. dhe tregtohet dhe regjistrohet në Turqi.
4. Dokumenti “Vërtetim _regjistrim_bari_Turqi” përmban Licencë, lëshuar Shoqërisë Anonime të Industrisë dhe Tregtisë së Medikamenteve Neutec Ilaç San Tic. A.S, nga Agjencia e Farmaceutikës dhe Pajisjeve Mjekësore të Turqisë, Ministria e Shëndetësisë, për produktin medikal human me emrin “Favimol 200 mg tabletë me veshje filmi. Evidentohet fakti se bari është i regjistruar në Turqi, dhe mbajtësi i Autorizimit/Prodhuesi është shoqëria Neutec Ilaç.

III.1.4. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përkthuar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.*

III.1.5. Në nenin 27 pika 6 të Vendimit nr. 914 datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se “Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogët teknike; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”*

III.1.6. Nga verifikimi i ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Intermed” sh.p.k në përmbushje të kërkesës së mësipërme të autoritetit kontraktor (III.1.1. dhe III.1.2.) rezulton se operatori ekonomik ankimues ka ofertuar me bar të paregjistruar në RSH. Për barnat e paautorizuara për tregtim në Republikën e Shqipërisë dhe specifikisht për barin që ofertohe, përveç të tjerave, kërkohet Autorizim nga MAH (Mbajtësi i Autorizimit të Tregtimit) ose nga prodhuesi ose distributori i autorizuar (ku të provohet/dokumentohet lidhja mes këtij të fundit dhe MAH apo prodhuesit) nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë barnat e tyre.

Në ofertën e ankimuesit të ngarkuar në SPE, rezulton se është paraqitur: Deklaratë Origjine ku deklarohe se prodhues i produktit është shoqëria Neutec Ilac San.Tic.A.S., dhe vendi i prodhimit është: ARIFIYE/SAKARYA Turqi; Licencë, lëshuar Shoqërisë Neutec Ilaç San Tic. A.S, nga Agjencia e Farmaceutikës dhe Pajisjeve Mjekësore të Turqisë, për produktin medikal human me emrin “Favimol 200 mg tabletë me veshje filmi. Sipas dokumentacionit bashkëngjitur licensës rezulton se mbajtësi i Autorizimit/Prodhuesi është shoqëria Neutec Ilac. Gjithashtu është paraqitur dokumenti “Autorizim_Prodhuesi_-MAH”, me logo të Neutec Ilac Sanayi Ticaret AS, datë 30.12.2020, sipas të cilit Neutec Ilaç San. Tic. AS mund të lëshojë këtë dokument për të autorizuar eksportimin e 6400 pako Favimol 200 mg, 40 tableta për në Shqipëri, nëpërmjet Corena Therapeutics Sarl. Corena Therapeutics Sarl blen produkte direkt nga prodhuesit e licensuar ose distributorët e autorizuar të licensuar të prodhuesit; si dhe është paraqitur dokumenti “Autorizim_MAH_Intermed”, i cili përmban Autorizim, lëshuar nga kompania Corena Therapeutics Sarl, e cila autorizon shoqërinë “Intermed” sh.p.k për produktin Favimol 200 mg. Sipas dokumentacionit të administruar në Komisionin e Prokurimit Publik, lidhur me procedurën e prokurimit objekt ankimimi, rezulton se produkti i ofertuar nga shoqëria “Intermed” sh.p.k është produkt i Neutec Ilac Turqi dhe Corena Therapeutics Sarl, është autorizuar (nga Neutec) për eksportimin e 6400 pako Favimol 200 mg, 40 tableta për në Shqipëri. Në këtë mënyrë operatori ekonomik ankimues, dokumenton lidhjen me MAH/Prodhues Neutec Ilac Sanayi Ticaret AS me kompaninë Corena Therapeutics Sarl, në përputhje me kërkesën e autoritetit kontraktor se *në rastin e parashikuar në pikën “c” të kriterëve të kapacitetit teknik të DST, kërkohet Autorizim nga MAH (Mbajtësi i Autorizimit të Tregtimit) ose nga prodhuesi ose distributori i autorizuar (ku të*

provohet/dokumentohet lidhja mes këtij të fundit dhe MAH apo prodhuesit) nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë barnat e tyre.

Përsa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se ankimuesi ka ofertuar në procedurën e mësipërme të prokurimit me produkte të kompanisë Neutec Ilac Sanayi Ticaret AS, nëpërmjet shoqërisë Corena Therapeutics Sarl, i autorizuar i Kompanisë Neutec, e cila autorizon shoqërinë “Intermed” sh.p.k, që për produktin “Favimol 200 mg tabletë me veshje filmi, të veprojë si shoqëri e vetme blerjeje, importi dhe shpërndarjeje i produktit tonë të regjistruar, për të vepruar ligjërisht dhe formalisht me Subjektet Publike dhe Private Shqiptare (Ministria e Shëndetësisë, Agjencia Kombëtare e Barnave, Agjencia e Prokurimeve Publike dhe autoritete të tjera shëndetësore në emër të Corena Therapeutics Sarl, përkatësisht nga MAH) gjatë dhe pas procedurës së prokurimit dhe regjistrimit në Shqipëri dhe të nënshkruajë çdo formë aplikimi për procedurat e importit dhe shpërndarjes dhe përgatisë dokumentacionin e nevojshëm ose përkthimet dhe të ekzekutojë të gjitha aktet e tjera që mund të kërkohen për importimin dhe shpërndarjen e produkteve tona në Republikën e Shqipërisë”.

III.1.7. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Sqarojmë se, për autoritetin kontraktor është e domosdoshme që një operator ekonomik pjesëmarrës të përmbushë kriteret e përcaktuara nga ai në dokumentet e tenderit duke vërtetuar se disponon kapacitetet ekonomike, financiare, teknike profesionale me dokumentacionin e paraqitur, dhe nuk duhet të jetë qëllim në vetvete skualifikimi i tij duke gjykuar dhe shqyrtuar këtë dokumentacion në mënyrë të njëanshme e sipërfaqësore.

Sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, Vendim i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Intermed” sh.p.k për procedurën e prokurimit me Nr.REF-82091-12-14-2020, me objekt: *“Blerje bari “Favipiravir 200 mg, Njësia Tabletë” për nevoja të QSU “Nënë Tereza” për një periudhë 12 mujore*”, me fond limit 76,969,446.20 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 11.01.2021, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Intermed” sh.p.k , duke e kualifikuar atë.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Intermed” sh.p.k
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 258 Protokolli

Datë 16.02.2021

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri